



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 48, datë 01/10/2004

**“MBI EMËRTIMIN NË TIRANË
TË NJË RRUGE ME EMRIN “MEDAR SHTYLLA”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, “Mbi emërtimin në Tiranë të një rruge më emrin “Medar Shtylla”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “I”, “II”, dhe “m”,

V E N D O S I;

1. Të miratojë emërtimin e rrugës që është krijuar nga ndërprerja e rrugës “Sulejman Delvina” me rrugën “Komuna e Parisit”, deri tek ndërprerja e saj me rrugën “Frang Bardhi”, me emrin “Medar Shtylla”.
2. Të planifikohet informimi publik dhe institucional i këtij emërtimi dhe të organizohet ceremonia përkatëse.
3. Për realizimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI